

Letër Pranimi për Shërbimin Bankar në Internet/Mobile

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Rruga Ismail Qemali, 27, Tiranë, Shqipëri

Unë/ne, i nënshkruari Z./Znj. _____,
Z./Znj. _____,

[(*ju lutemi plotësoni nëse jeni persona juridikë*)

në cilësinë e përfaqësuesit/përfaqësuesve të _____, _____ shoqëri/organizatë e rregjistruar në përputhje me legjislacionin e _____, me seli në _____, me anë të këtij dokumenti vërtetoj se unë/ne jemi personi/personat e emëruar me vendim dhe se unë/ne jemi të autorizuar në mënyrën e duhur të nisim kërkesat online në emër të personit juridik përmendur këtu.]

titullar/titullare i llogarisë/llogarive Intesa Sanpaolo Bank Albania, (më poshtë referuar si “Llogari/Llogaritë”), nëpërmjet këtij dokumenti dëshirojmë të aplikojmë lidhur me shërbimet bankare të ofruara përmes Internetit/Celularit (Mobile) të dhëna nga ju (më poshtë referuar si “Shërbimet Internet/Mobile Banking”)

Unë/ne nëpërmjet këtij dokumenti ju autorizojmë të vendosni “Shërbimet Internet/Mobile Banking”, të cilat na japin mua/neve mundësinë të kryejmë transaksione në përputhje me “Rregullat dhe Kushtet për Internet/Mobile Banking” e zbatueshme, të cilat unë/ne i kemi lexuar, kuptuar dhe pranuar plotësisht. Unë/ne kuptuam dhe pranuam se përdorimi im/ynë i Shërbimeve Internet/Mobile Banking, Kodit të përdoruesit dhe Fjalëkalimit të caktuar do të konsiderohet i njëjtë si firma ime/jonë duke ju autorizuar juve të kryeni çdo transaksion apo kërkesë drejtuar juve. Unë/ne ju autorizojmë juve të kryeni për mua/ne transaksionet e kërkuara, të transferoni transaksionet dhe debitoni në Llogarinë/Llogaritë time/tona tarifat përkatëse mujore. Unë/ne kuptojmë se Llogaria/Llogaritë ime/jonë mund të debitohet çdo muaj derisa unë/ne të anullojmë Shërbimet Internet/Mobile Banking, edhe nëse Shërbimet Internet/Mobile Banking nuk janë përdorur. Unë/ne pranojmë se përdorimi im/ynë i parë i Shërbimeve Internet/Mobile Banking nënkupton pranimin tim/tonë në sistem. Unë/ne e kuptojmë se duke përdorur Shërbimet Internet/Mobile Banking, unë/ne do të kemi mundësi hyrje në të gjitha llogaritë e kompanisë/institucionit, dhe se përdorimi im/jonë i Shërbimeve Internet/Mobile Banking për të hyrë në Llogari do të rregullohet nga Kushtet e Përgjithshme të Punës së Intesa Sanpaolo Bank Albania, Rregullat dhe Kushtet për Internet/Mobile Banking, si dhe Ligjet e Rregulloret e Republikës së Shqipërisë. Me qëllim që t’u përmbahemi sa më sipër, unë/ne ndërmarim dhe pranojmë t’u pajisim ju me çdo dokument që do të kërkohet për t’ju mundësuar të kryeni Shërbimet Internet/Mobile Banking e kërkuara. Në këtë kuptim, unë/ne pohojmë dhe pranojmë se ju nuk mund të përmbushni ndonjë transaksion përpara se të merrni kopjet origjinale të dokumentacionit të kërkuar dhe se ju nuk jeni përgjegjës për ndonjë vonesë ose mosplotësim të ndonjë pagese për shkak të mos marrjes së dokumentacionit të nevojshëm.

Unë/ne kuptojmë dhe pohojmë se ju rezervoni të drejtën të pezulloni ose përfundoni përdorimin tim/tonë të Shërbimit Internet/Mobile Banking në çdo moment dhe pranojmë e pohojmë se ju nuk jeni përgjegjës për ndonjë humbje si rezultat i një pagese të vonuar.

Unë/ne deklarojmë dhe pranojmë se ju nuk jeni përgjegjës për ndonjë gabim apo dëmtim të shkaktuar nga mosfunksionimi i kompjuterit tim, software, virus kompjuteri ose dhe probleme të lidhura me përdorimin e sistemit online dhe/ose për ndonjë humbje që vjen nga një virus kompjuteri apo problem të lidhur me të.

Unë/ne deklarojmë dhe pranojmë se ju nuk do të jeni përgjegjës për ndonjë dëm direkt, indirekt, të posaçëm, të rëndësishëm, ekonomik apo dëme të tjera të ardhur nga përdorimi apo mirëmbajtja e pajisjes, celularit, kompjuterit dhe software tim, përdorimit të Shërbimit Internet/Mobile Banking, Kodit të përdoruesit, Fjalëkalimit, Internet browser, Internet access, software apo në çdo rast tjetër, edhe pse ju jeni vënë në dijeni për mundësinë e tyre.

Unë/ne deklarojmë dhe pranojmë se unë/ne jemi plotësisht përgjegjës për përdorimin dhe fshehtësinë e Kodit të përdoruesit dhe Fjalëkalimit që mundësojnë hyrjen në Llogarinë time/tonë.

Në baze të kompetencave që parashikohen në Statut dhe kompetencave që më janë deleguar nga organi më i lartë vendim marrës i subjektit ligjor që Unë/ne përfaqësoj, Unë/ne emëroj individin/et njohur si “Përdorues” në dokumentin “Forma e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile”, përfaqësues të _____[vendos emrin e kompanisë dhe organizatës] i/të cili/cilët nëpërmjet shërbimit të Internet/Mobile Banking mund të kryej operacionet Bankare të përcaktuara në Formën e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile të cilat korrespondojnë me këtë përfaqësues, sipas modaliteteve dhe limiteve të specifikuara në “Formën e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile”. Përfaqësuesi(t) [përdoruesit] do të veprojnë në emër dhe për llogari të _____[vendos emrin e kompanisë dhe organizatës]; dhe për rrjedhojë kompania/organizata nuk do të ketë asnjë kundërshtim ose pretendim kundërshtim “Intesa Sanpaolo Bank Albania” Sh.A lidhur me operacionet bankare të ekzekutuara nga “Përdoruesit” në llogarinë/te e kompanisë/organizatës.

Unë/ne autorizoj aktivizimin e “Përdoruesit/sve, renditur në “Formën e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile” për ekzekutimin e operacioneve bankare të përcaktuara në seksionin “Forma e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile” që korrespondojnë me Përdoruesin respektiv, në përputhje me modalitetet dhe ligjet e përcaktuara në “Formën e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile”. Unë/ne kuptoj dhe pranoj që përdorimi i Shërbimeve të Internet/Mobile Banking, nga **Përdoruesi(t) e renditur** në “Formën e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile” dhe ID e Hyrjes dhe Flajëkalimit – në përputhje me modalitetet e përcaktuara në “Formën e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile” do të konsiderohen e vlefshme njësoj si firma me shkrim duke ju autorizuar të përfundoni të gjitha transaksionet ose kërkesat që ju komunikohen.

Unë/ne deklarojmë dhe pranojmë se përdorimi i Shërbimit Internet/Mobile Banking nga “Përdoruesi/t” për të hyrë në llogari do të rregullohet nga Kushtet e Përgjithshme të Punës së Intesa Sanpaolo Bank Albania, Rregullat dhe Kushtet për Internet/Mobile Banking, si dhe Ligjet e Rregulloret e Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në sa më sipër, hyrja dhe transaksionet në Llogari nëpërmjet shërbimit të Internet/Mobile Banking, do të kryhet nga unë/ne si përfaqësues i/të kompanisë/organizatës, ose nga “Përdoruesi/et” i cili mund të operoj në përputhje me kushtet, modalitetet dhe limitet e specifikuara në “Formën e Regjistrimit për Sherbimin Bankar në Internet/Mobile” sipas kompetencave të akorduara nga vetë unë/ne në cilësinë e përfaqësuesit/ve ligjor.

Unë/ne deklarojmë dhe pranojmë se kompania/organizata do t’ju njoftojë menjëherë, me shkrim, mbi ndryshimet në autorizimet e mëparshme, dhe ju do të gëzoni mbrojtje të plotë për të vepruar dhe mbështetur në vlefshmërinë dhe efektin e autorizimeve të mëparshme, deri në paraqitjen e një vërtetimi me shkrim ku deklarohet revokimi ose modifikimi i autorizimit.

Në përputhje me Nenin 686 të Kodit Civil Shqiptar, Unë/ne deklarojmë se kemi lexuar kuptuar dhe pranuar klauzolat dhe dipozitat e Kushteve të Punës që rregullojnë Internet/Mobile Banking: 1.2, 2.2, 2.3, 2.4.2, 2.5, 2.6, 3.4, 3.5, 3.6, 5.1, 5.5,5.6, 5.7, 7.

Data dhe Vendi _____,

Firma(t) e Aplikantit

Firma e punonjesit të bankës

Pas nënshkrimit, Letra e Pranimit dorezohet ose postohet pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania në adresën e mëposhtme:

Intesa Sanpaolo Bank Albania., Rruga Ismail Qemali, 27, P O Box 8319, Tirana, Albania